

**VENDIM**  
**Nr. 501, datë 1.8.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 413, DATË 26.5.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS, SI DHE TË**  
**STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AUTORITETIT TË**  
**AVIACIONIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 10 233, datë 11.7.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 413, datë 26.5.2010, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Lidhja nr. 3, e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lidhja nr. 4, e përmendur në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët” në Autoritetin e Aviacionit Civil, që punojnë në pozicione pune që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së këtij institucioni dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë “për kushte pune” prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh në muaj mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**